



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda::“Mbi miratimin e deklaratës për bashkëfinancimin e bashkisë në projektin “Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete e varfëra dhe të pa favorizuara per vitin 2026 “

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi në zbatim te ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, ”Për strehimin social”, VKM nr. 454, datë 3.7.2019 “ Për procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese” , VKM nr. 458, datë 3.7.2019,VKM nr.216,dt 13.4.2023

”Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Bashkia Berat e ka prioritet të saj strehimin e familjeve në nevojë të pa favorizuara e me probleme sociale .

Për ti ardhur ne ndihmë kësaj shtrese prej tre vitesh Bashkia Berat është bërë bashkëfinacuese në masën në projektit “ Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara“ prej 5 vitesh konkretisht viti 2020,2021,2022,2023,2025.

Situata financiare Gjithësej nga ky projekt kane përfituar 203 familje te cilave fale investimit u është përmirësuar banesa dhe kushtet e strehimit .

Për vitin 2020 nga zbatimi i këtij projekti përfituan përmirësim të banesave 14 familje me kosto totale të projektit në vlerën 11,930,760 leke .

Për vitin 2021, përfituan përmirësim të banesave 36 familje me kosto totale të projektit në vlerën 33,347,697 leke .

Për vitin 2022, përfituan përmirësim të banesave 47 familje me kosto totale të projektit në vlerën 45,884,667 leke .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Për vitin 2023, përfituan përmirësim të banesave 63 familje me kosto totale të projektit në vlerën 73,753,420 leke .

Për vitin 2025, përfituan përmirësim të banesave 43 familje me kosto totale të projektit në vlerën 31,731,879 leke .

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave ,Transportit dhe Shërbimeve .

Impakti social / grupet që preken:

Bashkia Berat edhe për këtë vit , nisur nga numri i madh i familjeve ne nevojë të identifikuar nga ana jonë, banesat e të cilave janë të amortizuara dhe jashte kushteve teknike,do te aplikoj pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit per projektin “ Përmirësim i kushteve te banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara“.

Një nga kushtet që Bashkia duhet të plotësojë për t’u kualifikuar për këtë projekt është përqindja e bashkëfinancimit për projektin, që për bashkine tonë është 30% e koston totale të projektit .

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 30 /01/2026,ora 09:00, shqyrtoi projekt vendimin “Mbi miratimin e deklaratës për bashkëfinancimin e bashkisë në projektin “Përmirësim I kushteve të banimit për komunitete e varfëra dhe të pa favorizuara per vitin 2026”

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI

:

1.Të miratoj , deklaratën për bashkëfinancimin e bashkisë Berat në projektin “ Përmirësim i kushteve te banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara“, për vitin 2026 në masën 30 % të koston totale të projektit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 30 /01/2026